

Udhëzues për mjekët me informata për përdorimin e barit Ruffixalo® (rivaroksaban)

Ky Udhëzues përfaqëson material edukativ që është i detyrueshëm si kusht për plasimin e barit Ruffixalo në treg, me qëllim të minimizimit të mëtejme të rreziqeve të rëndësishme të përzgjedhura.

Pa përmbajtje promociionale.

Informatat e ofruara në këtë material edukues nuk i zëvendësojnë informatat që janë dhënë në “Përmbledhjen e karakteristikave të produktit”(SmPC).Për informata të plota para se ta përdorni këtë bar, luteni ta lexoni ‘Përmbledhjen e karakteristikave të produktit’.

Ky material edukativ është i disponueshëm në faqen e internetit të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), në seksionin Publikime – Departamenti i Farmakovigjilencës.

Përmbledhje e rreziqeve të rëndësishme dhe masave të rekomanduara për parandalimin dhe/ose minimizimin e rreziqeve

- Të dhënat e popullatave që mund të jenë në rrezik më të madh nga gjakderdhja.
- Rekomandimet për uljen e dozimit në popullatat në rrezik.
- Udhëzimet për kalimin nga dhe në terapinë me Rifaxalo.
- Domosdoshmëria e përdorimit të tabletave Rifaxalo 15 mg dhe 20 mg me ushqim.
- Mjekimi në rast të mbidozimit me këtë bar.
- Aplikimi i testeve të koagulimit dhe interpretimi i tyre.
- Nevoja për t'ua shpjeguar pacientëve:
 - shenjat dhe simptomat e gjakderdhjes dhe kur duhet të kërkojë ndihmë mjekësore;
 - rëndësinë e respektimit të terapisë;
 - nevojën për t'i marrë tabletat 15 mg dhe 20 mg me ushqim;
 - nevojën për ta mbajtur gjithmonë me vete Librezën e Pacientit, e cila përfshihet në secilin paketim të këtij bari;
 - nevojën për t'i informuar profesionistët e kujdesit shëndetësor se po e përdorin barin Rifaxalo para operacionit ose para ndonjë procedure invazive.

Përmbajtja	
Një udhëzues për mjekët.....	5
Libreza e paralajmërimit të pacientit.....	5
Rekomandime për dozimin.....	6
Parandalimi i goditjes në tru dhe embolizmit sistematik tek pacientët e rritur me fibrilacion atrial jovalvular	6
Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave.....	6
Kohëzgjatja e terapisë.....	6
Doza e humbur	6
Pacientët me fibrilacion atrial jovalvular që i nënshtrohen intervenimit koronar perkutan (PCI - percutaneous coronary intervention) me implantim të stendës.	7
Pacientët që i nënshtrohen kardioversionit.....	7
Terapia e trombozës së venave të thella (DVT) dhe embolizmit pulmonar (PE) dhe parandalimi i përsëritjes së DVT dhe PE.....	8
Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave.....	9
Kohëzgjatja e terapisë.....	9
Doza e humbur	9
Parandalimi i ngjarjeve aterotrombotike tek pacientët e rritur me sëmundje të arteries koronare (CAD) ose sëmundje simptomatike të arteries periferike (PAD) dhe me rrezik të lartë nga ngjarjet ishemike .	10
Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave.....	10
Kohëzgjatja e terapisë.....	10
Përdoret njëkohësisht me terapi antitrombocitare	10
Paralajmërime dhe masa paraprake të veçanta për përdorim tek pacientët me CAD / PAD.....	10
Doza e humbur	11
Parandalimi i ngjarjeve aterotrombotike tek pacientët e rritur pas sindromës akute koronare (ACS) me biomarkerë kardiale të rritur.....	12
Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave.....	12
Kohëzgjatja e terapisë.....	12
Përdoret njëkohësisht me terapi antitrombocitare	12
Paralajmërime dhe masa paraprake të veçanta për përdorim tek pacientët me ASC.....	13
Doza e humbur	13
Parandalimi i tromboembolizmit venoz (VTE) tek pacientët e rritur që i nënshtrohen ndonjë procedure kirurgjikale zgjedhore të implantimit të legenit apo gjunjëve artificialë.....	14
Kohëzgjatja e terapisë.....	14
Doza e humbur	14
Administrim oral.....	14
Përdorimi i barit gjatë ndërhyrjes kirurgjikale	14
Anestezia apo punkcioni spinal/epidural	15
Kalimi i pacientëve nga antagonistët e vitaminës K (VKA) në Rifaxalo.....	16
Kalimi i pacientëve nga Rifaxalo në VKA.....	17

Kalimi i pacientëve nga antikoagulantë parenteral në Rifaxal	17
Kalimi i pacientëve nga Rifaxal në antikoagulantë parenteralë	18
Popullatat në rrezik potencialisht më të madh nga gjakderdhja	18
Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave	18
Pacientët me faktorë të tjerë të rrezikut nga gjakderdhja	19
Pacientët me kancer	19
Kundërindikacionet e tjera	19
Mbidoza	20
Testet e koagulimit	20
Pasqyrë e përgjithshme e dozimit tek pacientët e rritur*	21
Parandalimi i ngjarjeve aterotrombotike tek pacientët e rritur pas ACS me biomarkerë kardiale të rritur	22
Raportimi i efekteve anësore	23

Një udhëzues për mjekët

Në këtë "Udhëzues për Mjekët" ka rekomandime për përdorimin e barit Ruffixalo, të cilat do të minimizonin rrezikun nga gjakderdhja gjatë terapisë me këtë bar. Informatat e ofruara në këtë "Udhëzues për Mjekët" nuk i zëvendësojnë ato që janë ofruar në "Përmbledhjen e karakteristikave të produktit".

Para se ta përshkruani këtë bar, luteni ta lexoni "Përmbledhjen e karakteristikave të produktit".

Libreza e paralajmërimit të pacientit

Çdo pacient të cilit i është përshkruar Ruffixalo do ta marrë një "librezë të pacientit", e cila është e disponueshme në secilën pako të këtij bari.

Çdo pacienti dhe kujdestari duhet t'i shpjegohen pasojat e mundshme të terapisë antikoagulante dhe rëndësia e respektimit të terapisë, shenjat e gjakderdhjes dhe kur duhet të kërkohet ndihmë mjekësore.

Libreza e paralajmërimit të pacientit ka për qëllim ta informojë mjekun dhe dentistin për terapinë antikoagulante të pacientit dhe përmban informata për kontaktim në rast të urgjencës. Pacienti duhet të informohet se duhet ta mbajë gjithmonë me vete "librezën e pacientit" dhe t'ia tregojë atë çdo profesionisti të kujdesit shëndetësor.

Rekomandime për dozimin

Parandalimi i goditjes në tru dhe embolizmit sistemik tek pacientët e rritur me fibrilacion atrial jovalvular

Doza e rekomanduar për parandalimin e goditjes në tru dhe embolizmit sistemik tek pacientët me fibrilacion atrial jovalvular është 20 mg një herë në ditë.

Skema e dozimit



Terapia e vazhdueshme

Rufixalo 20 mg një herë në ditë*

Të merret me ushqim

* Për skemën e rekomanduar të dozimit tek pacientët me fibrilacion atrial dhe dëmtim të moderuar ose të rëndë të veshkave shih më poshtë.

Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave

Tek pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave të moderuar (pastrimi i kreatininës 30-49 ml/min) ose të rëndë (pastrimi i kreatininës 15-29 ml/min), doza e rekomanduar është 15 mg një herë në ditë. Rufixalo duhet të përdoret me kujdes tek pacientët me dëmtim të rëndë të veshkave (pastrimi i kreatininës 15-29 ml/min) dhe përdorimi i tij nuk rekomandohet tek pacientët me pastrim të kreatininës < 15 ml/min.

Rufixalo duhet të përdoret me kujdes tek pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave të cilët marrin njëkohësisht barna të tjera që i rrisin përqendrimit plazmatike të rivaroksabanit.

Kohëzgjatja e terapisë

Terapia me barin Rufixalo duhet të aplikohet për një periudhë të gjatë nëse dobia nga parandalimi i goditjes në tru është më e madhe se rreziku nga gjakderdhja.

Doza e humbur

Nëse pacienti e humb një dozë, ai duhet të marrë Rufixalo menjëherë dhe nga dita e ardhshme të vazhdojë ta marrë barin një herë në ditë sipas përshkrimit. Nuk lejohet të merren dy doza gjatë të njëjtës ditë për ta kompensuar dozën e humbur.

Pacientët me fibrilacion atrial jovalvular që i nënshtrohen intervenimit koronar perkutan (PCI - percutaneous coronary intervention) me implantim të stendës.

Ka përvojë të kufizuar me doza të reduktuara të Ruffixalos 15 mg një herë në ditë (ose Ruffixalos 10 mg një herë në ditë, për pacientët me funksion renal të dëmtuar mesatarisht (pastrimi i kreatinës 30-49 ml/min)), krahas përdorimit të një frenuesi të receptorit P2Y12, deri në një maksimum prej 12 muajsh, tek pacientët me fibrilacion atrial jovalvular që kanë nevojë për terapi me antikoagulantë oral dhe që i nënshtrohen PCI me implantim të stendës.

Pacientët që i nënshtrohen kardioversionit

Terapia me Ruffixalo mund të fillohet ose të vazhdohet tek pacientët që mund të kenë nevojë për kardioversion.

Për kardioversionin e udhëhequr nga ekokardiografia transezofageale (TEE-ja) tek pacientët që nuk janë trajtuar më parë me antikoagulantë, terapia me Ruffixalo duhet të fillojë të paktën katër orë para kardioversionit, për të siguruar antikoagulim të mjaftueshëm. Para kardioversionit, të gjithë pacientëve duhet t'u kërkojë të konfirmojnë se e kanë marrë Ruffixalon sipas përshkrimit. Kur merret vendimi për fillimin e terapisë dhe kohëzgjatjen e saj, duhet të merren parasysh rekomandimet e udhëzimeve aktuale për terapinë antikoagulante tek pacientët që i nënshtrohen kardioversionit.


Terapia e trombozës së venave të thella (DVT) dhe embolizmit pulmonar (PE) dhe parandalimi i përsëritjes së DVT dhe PE

Pacientët në fillim i marrin 15 mg dy herë në ditë për tre javët e para. Pas terapisë fillestare, pacientët i marrin 20 mg një herë në ditë si terapi e vazhdueshme.

Kur indikohet parandalimi i zgjatur i DVT ose BE së përsëritur (pas përfundimit të të paktën gjashtë muajve të terapisë për trombozë të thellë të venave ose embolizëm pulmonar), doza e rekomanduar është 10 mg. **një herë në ditë**. Tek pacientët që konsiderohen me rrezik të lartë nga DVT ose PE e përsëritur, siç janë ata me komorbiditete të komplikuar ose ata tek të cilët DVT ose PE e përsëritur ka ndodhur gjatë profilaksisë së zgjatur me Rufixalo 10 mg **një herë në ditë**, është e nevojshme të merret në konsideratë marrja e barit Rufixalo në një dozë prej 20 mg. **një herë në ditë**.

Rufixalo 10 mg nuk rekomandohet si terapi fillestare për DVT dhe për PE brenda gjashtë muajve të parë të mjekimit.

Skema e dozimit



Tabletat Rufixalo 10 mg: MUND TË MERREN ME OSE PA USHQIM. Tabletat Rufixalo 15 dhe 20 mg: DUHET TË MERREN ME USHQIM.

*Për skemën e rekomanduar të dozimit tek pacientët me DVT ose BE dhe dëmtim të moderuar ose të rëndë të veshkave, shih tekstin e mëposhtëm.

Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave

Pacientët me dëmtim të moderuar (pastrimi i kreatininës 30-49 ml/min) ose të rëndë (pastrimi i kreatininës 15-29 ml/min) të funksionit renal që mjekohen për DVT akute, PE akute dhe parandalim të DVT dhe PE të përsëritur duhet t'i marrin 15 mg dy herë në ditë gjatë tri javëve të para.

Pas kësaj, doza e rekomanduar është 20 mg një herë në ditë. Ulja e dozës nga 20 mg një herë në ditë në 15 mg një herë në ditë duhet të merret në konsideratë për pacientin kur rreziku i vlerësuar nga gjakderdhja e tejkalon rrezikun e përsëritjes së DVT dhe PE. Rekomandimi për marrjen e 15 mg bazohet në modelin farmakokinetik dhe nuk është testuar në këto kushte klinike. Rifaxalo duhet të administrohet me kujdes tek pacientët me funksion renal të dëmtuar të rëndë (pastrimi i kreatininës 15-29 ml/min) dhe nuk rekomandohet tek pacientët me pastrim të kreatininës < 15 ml/min. Kur doza e rekomanduar është 10 mg një herë në ditë (pas së paku gjashtë muajsh terapi), nuk ka nevojë për ndonjë përshtatje të dozës ditore të rekomanduar.

Rifaxalo duhet të përdoret me kujdes tek pacientët me funksion renal të dëmtuar¹ të cilët marrin njëkohësisht barna të tjera që i rrisin përqendrimet e rivaroksabanit në plazmë.

Kohëzgjatja e terapisë

Është e nevojshme të merret në konsideratë një kohëzgjatje e shkurtër e mjekimit (të paktën tre muaj) tek pacientët me DVT dhe PE të provokuar nga faktorë të mëdhenj dhe kalimtarë të rrezikut (domethënë, ndonjë ndërhyrje kirurgjikale apo trauma e madhe e kohëve të fundit). Një kohëzgjatje më e gjatë e mjekimit duhet të merret në konsideratë tek pacientët me DVT ose PE të paprovokuar, të ndërlidhur me faktorë të mëdhenj dhe kalimtarë të rrezikut, DVT ose PE të paprovokuar ose histori të DVT apo PE-së së përsëritur.

Doza e humbur

- **Periudha e dozimit dy herë në ditë** (15 mg dy herë në ditë gjatë tri javëve të para): Nëse pacienti e humb një dozë, ai duhet të marrë Rifaxalo menjëherë për t'u siguruar që doza ditore e Rifaxalo të jete 30 mg. Në këtë rast, mund të merren dy tableta 15 mg përnjëherë. Të nesërmen, pacienti duhet ta vazhdojë me dozën e rregullt prej 15 mg dy herë në ditë, siç rekomandohet.
- **Periudha e dozimit një herë në ditë** (pas tri javësh): Nëse pacienti e humb një dozë, ai duhet të marrë Rifaxalo menjëherë dhe nga dita e ardhshme të vazhdojë ta marrë barin sipas rekomandimit – një herë në ditë. Doza nuk duhet të dyfishohet gjatë të njëjtës ditë për ta kompensuar dozën e humbur.

¹ me funksion mesatarisht të dëmtuar të veshkave (pastrimi i kreatininës 30-49 ml/min) për Rifaxalo 10 mg

Parandalimi i ngjarjeve aterotrombotike tek pacientët e rritur me sëmundje të arteries koronare (CAD) ose sëmundje simptomatike të arteries periferike (PAD) dhe me rrezik të lartë nga ngjarjet ishemike

Skema e dozimit

Kohëzgjatja individuale e mjekimit

Rufixalo 2.5 mg dy herë në ditë

Rufixalo 2.5 mg MUND TË MERRET ME OSE PA USHQIM.

Pacientët që marrin Rufixalo 2.5 mg dy herë në ditë duhet të marrin gjithashtu 75 deri në 100 mg acid acetilsalicilik (ASA) në ditë.

Tek pacientët me revaskularizim të suksesshëm të gjymtyrëve të poshtme (me anë të procedurës kirurgjikale ose endovaskulare, përfshirë procedurën e kombinuar) për shkak të PAD-së simptomatike, mjekimi nuk duhet të fillojë para se të arrihet hemostaza (shih edhe paragrafin 5.1 të “Përmbledhjes së karakteristikave të produktit”).

Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave

Nuk kërkohet përshtatja e dozës tek pacientët me dëmtim mesatar të veshkave (pastrimi i kreatininës 30-49 ml/min). Rufixalo duhet të përdoret me kujdes tek pacientët me dëmtim të rëndë të funksionit renal (pastrimi i kreatininës 15-29 ml/min). Nuk rekomandohet përdorimi i barit tek pacientët me pastrim të kreatininës < 15 ml/min.

Tek pacientët me dëmtim mesatar të funksionit renal (pastrimi i kreatininës nga 30 deri në 49 ml/min), të cilët përdorin njëkohësisht barna të tjera që e rrisin përqendrimin e rivaroksabanit në plazmë, Rufixalo duhet të përdoret me kujdes.

Kohëzgjatja e terapisë

Kohëzgjatja e mjekimit duhet të përcaktohet individualisht për secilin pacient, duke u bazuar në kontrolle të rregullta, duke e marrë parasysh rrezikun nga ngjarjet trombotike kundrejt rrezikut nga gjakderdhja.

Përdoret njëkohësisht me terapi antitrombotike

Tek pacientët me ngjarje trombotike akute apo ndërhyrje vaskulare që kërkojnë terapi antitrombotike të dyfishtë, vazhdimi i administrimit të Rufixalo 2.5 mg dy herë në ditë duhet të vlerësohet varësisht nga lloji i ngjarjes apo ndërhyrjet dhe terapia antitrombotike.

Paralajmërime dhe masa paraprake të veçanta për përdorim tek pacientët me CAD / PAD

Tek pacientët me CAD / PAD me rrezik të lartë nga ngjarjet ishemike, efikasiteti dhe siguria e barit Rufixalo 2.5 mg dy herë në ditë janë testuar në kombinim me ASA.

Tek pacientët që i janë nënshtruar kohëve të fundit procedurës së rivaskularizimit të gjymtyrëve të poshtme për shkak të sëmundjes së arterieve perriferike (PAD) simptomatike, efikasiteti dhe siguria e Ruffixalos në një dozë prej 2.5 mg dy herë në ditë është studiuar në kombinim me barin antitrombocitar acidin acetilsalicilik (ASA) vetëm ose ASA me administrim shtesë afatshkurtër të klopidoqrelit. Nëse është e nevojshme, terapia antitrombocitare e dyfishtë me klopidoqrel duhet të jetë afatshkurtër; terapia antitrombocitare e dyfishtë afatgjatë duhet të shmanget. Pacientëve që i janë nënshtruar kohëve të fundit ndonjë procedure të suksesshme të rivaskularizimit të gjymtyrëve të poshtme (me ndërhyrje kirurgjikale ose endovaskulare, duke përfshirë procedurën e kombinuar), për shkak të SAP-së simptomatike, u është lejuar gjithashtu që ta përdornin dozën standarde të klopidoqrelit një herë në ditë për një maksimum prej gjashtë muajsh (shih edhe paragrafin 5.1 të "Përmbledhjes së karakteristikave të produktit").

Mjekimi në kombinim me barna antitrombocitare të tjera, p.sh. prasugrel ose ticagrelor, nuk është testuar dhe nuk rekomandohet.

Mjekimi i njëkohshëm i CAD / PAD me Ruffixalo 2.5 mg dhe ASA kundërlindkohet tek pacientët me goditje në tru hemorragjike ose lakunare të mëparshme ose me çdo lloj goditjeje në tru gjatë muajit të fundit. Mjekimi me Ruffixalo 2.5 mg duhet të shmanget tek pacientët me goditje në tru ose atak ishemik kalimtar (TIA) të mëparshëm që marrin terapi antitrombocitare të dyfishtë.

Nëse Ruffixalo administrohet me ASA, duhet të përdoret me kujdes tek pacientët me CAD/PAB:

- të moshës ≥ 75 vjeç. Raporti dobi-rrezik i mjekimit për secilin pacient duhet të vlerësohet rregullisht.
- me peshë trupore më të ulët (< 60 kg).
- te pacientët me CAD që kanë dështim të rëndë simptomatik të zemrës. Të dhënat e studimeve klinike sugjerojnë se pacientët e tillë mund të kenë më pak dobi nga mjekimi me Ruffixalo (shih paragrafin 5.1 të "Përmbledhjes së karakteristikave të produktit" për sqarime të mëtejshme).

Doza e humbur

Nëse humbet një dozë, pacienti duhet të vazhdojë ta marrë dozën e rekomanduar të Ruffixalos 2.5 mg sipas orarit. Doza nuk duhet të dyfishohet për ta kompensuar dozën e humbur.

Parandalimi i ngjarjeve aterotrombotike tek pacientët e rritur pas sindromës akute koronare (ACS) me biomarkerë kardiakë të rritur

Skema e dozimit

Kohëzgjatja individuale e mjekimit

Rufixalo 2.5 mg dy herë në ditë

Rufixalo 2.5 mg MUND TË MERRET ME OSE PA USHQIM.

Për më tepër, me Rufixalo 2.5 mg, pacientët duhet ta marrin një dozë ditore prej 75-100 mg acid acetilsalicilik ose dozën ditore të acidit acetilsalicilik 75-100 mg, krahas një doze ditore prej 75 mg klopidoqrel ose dozave të zakonshme ditore të tiklopidinës.

Doza fillestare e rekomanduar e Rufixalos është 2.5 mg dy herë në ditë dhe duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur pas stabilizimit të sindromës akute koronare, dhe jo më herët se 24 orë pas pranimit në spital, ndërsa në kohën kur kërkohet antikoagulimi parenteral, terapia zakonisht ndërpritet.

Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave

Nuk kërkohet përshtatja e dozës tek pacientët me dëmtim mesatar të veshkave (pastrimi i kreatininës 30-49 ml/min). Rufixalo duhet të përdoret me kujdes tek pacientët me dëmtim të rëndë të veshkave (pastrimi i kreatininës 15-29 ml/min) dhe përdorimi i tij nuk rekomandohet tek pacientët me pastrim të kreatininës < 15 ml/min.

Tek pacientët me dëmtim mesatar të funksionit renal (pastrimi i kreatininës 30-49 ml/min), të cilët përdorin njëkohësisht barna të tjera që e rrisin përqendrimin e rivaroksabanit në plazmë, Rufixalo duhet të përdoret me kujdes.

Kohëzgjatja e terapisë

Kohëzgjatja e mjekimit duhet të përcaktohet individualisht për secilin pacient, duke u bazuar në kontrolle të rregullta, duke e marrë parasysh rrezikun e ngjarjeve ishemiike dhe rrezikun nga gjakderdhja. Mjekimi afatgjatë përtej 12 muajve duhet të vendoset individualisht për secilin pacient, sepse përvoja e aplikimit deri në 24 muaj është e kufizuar.

Përdoret njëkohësisht me terapi antitrombotike

Tek pacientët me ngjarje trombotike akute apo ndërhyrje vaskulare që kërkojnë terapi antitrombotike të dyfishtë, vazhdimi i administrimit të Rufixalo 2.5 mg dy herë në ditë duhet të vlerësohet varësisht nga lloji i ngjarjes apo ndërhyrjet dhe terapia antitrombotike.

Paralajmërime dhe masa paraprake të veçanta për përdorim tek pacientët me ASC

Efikasiteti dhe siguria e RufiXalos 2.5 mg dy herë në ditë tek pacientët me sindromë akute koronare të kohëve të fundit janë studiuar në kombinim me barnat antitrombocitare: me ASA ose ASA krahas klopidoqrelit/tiklopidinës.

Mjekimi në kombinim me barna antitrombocitare të tjera, p.sh. prasugrel ose ticagrelor, nuk është testuar dhe nuk rekomandohet.

Kujdes kërkohet kur përdoret Rufixalo me ASA ose me ASA me shtimin e klopidoqrelit ose tiklopidinës, tek pacientët me ACS:

- në moshën ≥ 75 vjeç. Raporti dobi-rrezik i mjekimit për secilin pacient duhet të vlerësohet rregullisht.
- më pak peshë trupore (< 60 kg)

Mjekimi i njëkohshëm i ACS-së me Rufixalo dhe barna antitrombocitare kundërrindikohet tek pacientët me goditje në tru ose atak ishemik kalimtar (TIA) të mëparshëm.

Doza e humbur

Nëse humbet një dozë, pacienti duhet të vazhdojë ta marrë dozën e rekomanduar të RufiXalos 2.5 mg sipas orarit. Doza nuk duhet të dyfishohet për ta kompensuar dozën e humbur.

Parandalimi i tromboembolizmit venoz (VTE) tek pacientët e rritur që i nënshtrohen ndonjë procedure kirurgjikale zgjedhore të implantimit të legenit apo gjunjëve artificiale

Doza e rekomanduar është Ruffixalo 10 mg oralisht një herë në ditë. Doza e parë duhet të merret 6-10 orë pas operacionit, marrë parasysh se është konstatuar hemostaza.

Kohëzgjatja e terapisë

Kohëzgjatja e mjekimit varet nga rreziku individual i pacientit për zhvillimin e tromboembolizmit venoz, i cili përcaktohet nga lloji i kirurgjisë ortopedike.

- Kohëzgjatja e rekomanduar e mjekimit për pacientët që i nënshtrohen ndonjë ndërhyrjeje kirurgjikale të madhe në legen, kohëzgjatja e rekomanduar e terapisë është 5 javë.
- Kohëzgjatja e rekomanduar e mjekimit për pacientët që i nënshtrohen ndonjë ndërhyrjeje kirurgjikale të madhe në gju, kohëzgjatja e rekomanduar e terapisë është 2 javë.

Doza e humbur

Nëse humbet një dozë, pacienti duhet të marrë Ruffixalo menjëherë dhe të nesërmen të vazhdojë ta marrë barin një herë në ditë si më parë.

Administrimi oral

Tabletat Ruffixalo 2.5 mg dhe 10 mg mund të merren me ose pa ushqim.

Ruffixalo 15 mg dhe 20 mg duhet të merren me ushqim. Marrja e këtyre dozave në të njëjtën kohë me ushqimin siguron përthithjen e nevojshme të barit dhe kështu siguron biodisponueshmëri të lartë pas administrimit oral.

Për pacientët që nuk mund ta gëlltisnin tërë tabletën, tableta Ruffixalo mund të shtypet dhe të përzihet me ujë ose pure molle menjëherë para se të merret dhe të aplikohet oralisht. Pas administrimit të Ruffixalo 15 mg ose 20 mg të veshur me film dhe të grimcuar, doza duhet të pasohet menjëherë me ushqim.

Një tabletë e grimcuar Ruffixalo mund të jepet nëpërmjet një sonde gastrike, pasi të konfirmohet që sonda është vendosur siç duhet në stomak. Tableta e grimcuar duhet të jepet me një sasi të vogël uji përmes sondës gastrike, e pastaj sonda duhet të shpëlahet me ujë. Pas administrimit të tabletës së grimcuar të Ruffixalo 15 mg ose 20 mg të veshur me film, doza duhet të pasohet menjëherë me ushqim.

Përdorimi i barit gjatë ndërhyrjes kirurgjikale

Nëse kërkohet ndonjë procedurë apo ndërhyrje kirurgjikale invazive, nëse është e mundur dhe bazuar në vlerësimin klinik të mjekut:

- ☐ Tabletata Ruffixalo prej 10, 15 dhe 20 mg duhet të ndërpriten të paktën 24 orë para ndërhyrjes.

□ Tabletat Ruffixalo 2.5 mg duhet të ndërpriten të paktën 12 orë para ndërhyrjes, nëse është e mundur dhe bazuar në vlerësimin klinik të mjekut. Nëse ndërhyrja nuk mund të shtyhet, rreziku i shtuar nga gjakderdhja duhet të vlerësohet kundrejt urgjencës së ndërhyrjes.

Administrimi i barit Ruffixalo duhet të vazhdojë sa më shpejt që të jetë e mundur pas procedurës apo ndërhyrjes kirurgjikale invazive, me kusht që gjendja klinike ta lejojë këtë dhe të jetë konstatuar hemostaza e përshtatshme.

Anestezioni apo punkcioni spinal/epidural

Gjatë anestezisë neuroaksiale (anestezise spinale/epidurale) ose gjatë punkcionit spinal/epidural, pacientët që mjekohen me barna antitrombocitare për parandalimin e komplikacioneve tromboembolike janë në rrezik më të madh nga zhvillimi i ndonjë hematome epidurale ose spinale, e cila mund të çojë në paralizë afatgjatë ose të përhershme. Rreziku nga këto ngjarje mund të rritet me përdorimin postoperativ të kateterëve epiduralë të përhershëm ose me përdorimin e njëkohshëm të barnave që ndikojnë në hemostazë. Ky rrezik mund të rritet gjithashtu me punksiione epidurale ose kurrizore traumatike ose të përsëritura. Pacientët duhet të monitorohen shpesh për shenja dhe simptoma të çrregullimeve neurologjike (p.sh., mpirje ose dobësi të këmbëve, mosfunksionim të zorrëve ose fshikëzës). Nëse vërehen probleme neurologjike, ato duhet të diagnostikohen dhe mjekohen menjëherë. Para ndërhyrjes neuroaksiale, mjeku duhet ta bëjë një vlerësim të dobisë së mundshme kundrejt rrezikut tek pacientët që marrin terapi antikoagulante ose tek pacientët që duhet të marrin terapi antikoagulante për tromboprofilaksë.

Rekomandime për indikacione specifike

- ◆ **Parandalimi i goditjes në tru dhe embolizmit sistemik tek pacientët e rritur me fibrilacion atrial joalvular**
- ◆ **Mjekimi i DVT-së dhe PE-së dhe parandalimi i DVT-së dhe PE-së përsëritëse tek pacientët e rritur**

Nuk ka përvojë klinike me përdorimin e tabletave Ruffixalo 15 mg dhe 20 mg tek pacientët e rritur në këto situata. Për ta zvogëluar rrezikun potencial nga gjakderdhja që ndërlidhet me përdorimin e njëkohshëm të Ruffixalos dhe anestezisë neuroaksiale (epidurale/spinale) ose punkcionit kurrizor, duhet të merret në konsideratë profili farmakokinetik i rivaroksabanit. Vendosija ose heqja e një kateteri epidural ose punkcioni lumbar bëhet më së miri kur efekti antikoagulant i Ruffixalos vlerësohet si i ulët. Megjithatë, koha e saktë që nevojitet për ta arritur një efekt antikoagulues mjaftueshëm të ulët tek secili pacient nuk dihet dhe duhet të vlerësohet sipas urgjencës së procedurës diagnostikuese.

Për heqjen e kateterit epidural dhe bazuar në karakteristikat farmakokinetike të përgjithshme, duhet të kalojë të paktën dyfishi i gjysmëkohës së eliminimit, ose të paktën 18 orë tek pacientët e rinj të rritur dhe 26 orë tek pacientët e moshuar nga administrimi i fundit i Ruffixalos (shih paragrafin 5.2 të "Përmbledhjes së karakteristikave të produktit"). Pas heqjes së kateterit, duhet të kalojnë të paktën 6 orë para administrimit të dozës tjetër të Ruffixalos. Nëse ndodh një punkcion traumatik, administrimi i Ruffixalos duhet të shtyhet për 24 orë.

♦ **Parandalimi i VTE-së tek pacientët e rritur që i nënshtrohen procedurës kirurgjikale zgjedhore të implantimit të legenit ose gjurit artificial**

Për ta zvogëluar rrezikun potencial nga gjakderdhja që ndërlikohet me përdorimin e njëkohshëm të Rufixalos dhe anestezisë neuroaksiale (epidurale/spinale) ose punkSIONIT kurrizor, duhet të merret në konsideratë profili farmakokinetik i Rufixalos.

Vendosja ose heqja e një kateteri epidural ose punkSIONI lumbar bëhet më së miri kur efekti antikoagulant i Rufixalos vlerësohet si i ulët (shih paragrafin 5.2 të "Përmbledhjes së karakteristikave të produktit").

Para heqjes së kateterit epidural, duhet të kalojnë të paktën 18 orë që nga administrimi i fundit i Rufixalos. Pas heqjes së kateterit, duhet të kalojnë të paktën 6 orë para administrimit të dozës tjetër të Rufixalos. Nëse ndodh një punkSION traumatik, administrimi i Rufixalos duhet të shtyhet për 24 orë.

- ♦ **Parandalimi i ngjarjeve aterotrombotike tek pacientët e rritur që kanë sëmundje të arteries koronare (CAD) ose sëmundje simptomatike të arteries periferike (PAD) me një rrezik të lartë nga ngjarjet ishemike**
- ♦ **Parandalimi i ngjarjeve aterotrombotike tek pacientët e rritur pas sindromës akute koronare (ACS) me biomarkerë kardiale të rritur**

Nuk ka përvojë klinike me përdorimin e Rufixalo 2.5 mg dhe barnave antitrombotike në këto situata. Përdorimi i frenuesve të grumbullimit të trombociteve duhet të ndërpritet sipas rekomandimeve të prodhuesit të rënditura në informatat për barin.

Për ta zvogëluar rrezikun potencial nga gjakderdhja që ndërlikohet me përdorimin e njëkohshëm të Rufixalos dhe anestezisë neuroaksiale (epidurale/spinale) ose punkSIONIT kurrizor, duhet të merret në konsideratë profili farmakokinetik i Rufixalos.

Vendosja ose heqja e një kateteri epidural ose punkSIONI lumbar bëhet më së miri kur efekti antikoagulant i Rufixalos vlerësohet si i ulët (shih paragrafin 5.2 të "Përmbledhjes së karakteristikave të produktit"). Megjithatë, koha e saktë që nevojitet për të arritur një efekt antikoagulues mjaftueshëm të ulët tek secili pacient nuk dihet.

Kalimi i pacientëve nga antagonistët e vitaminës K (VKA) në Rufixalo

Kalimi i pacientëve nga VKA në Rufixalo



*Shih rekomandimin e dozës për dozën e kërkuar ditore


Tek pacientët që marrin barna për **parandalim të goditjes në tru dhe embolizmit sistemik**, mjekimi me antagonistë të vitaminës K duhet të ndërpritet dhe mjekimi të fillojë me Rufixalo kur INR është ≤ 3.0 .

Tek pacientët që mjekohen për **trombozë të venave të thella, embolizmi pulmonar dhe parandalimi i trombozës së venave të thella dhe embolizmit pulmonar të përsëritur**, mjekimi me antagonistë të vitaminës K duhet të ndërpritet dhe mjekimi të fillojë me Rufixalo kur INR është ≤ 2.5 .

Matja e INR-së nuk është e përshtatshme për matjen e aktivitetit antikoagulant të Rufixalos dhe, për këtë arsye, nuk duhet të përdoret për këtë qëllim. Mjekimi vetëm me Rufixalo nuk kërkon monitorim rutinor të parametrave të koagulimit.

Kalimi i pacientëve nga Rufixalo në VKA

Kalimi i pacientëve nga Rufixalo në VKA



*Shih rekomandimin e dozës për dozën e kërkuar ditore

Është e rëndësishme të sigurohet antikoagulum i përshtatshëm duke e minimizuar rrezikun nga gjakderdhja gjatë kalimit nga një terapi në tjetrën.

Kur kalohet në VKA, Rufixalo dhe VKA duhet të jepen njëkohësisht derisa INR të jetë ≥ 2.0 . Gjatë dy ditëve të para të periudhës së tranzicionit, duhet të administrohet doza fillestare standarde e VKA-së, e ndjekur nga dozimi i VKA-së bazuar në rezultatet e testit INR.

Matja e INR-së nuk është e përshtatshme për përcaktimin e aktivitetit antikoagulant të Rufixalos si bar. Kur pacientët përdorin Rufixalo dhe VKA njëkohësisht, **INR-ja nuk duhet të matet më herët se 24 orë pas dozës së mëparshme, por duhet të përcaktohet para se të merret doza e ardhshme e Rufixalos.** Kur ndërpritet mjekimi me Rufixalo, vlerat e INR-së të matura të paktën 24 orë pas dozës së fundit e pasqyrojnë dozën e VKA-së.

Kalimi i pacientëve nga antikoagulantit parenteral në Rufixalo

- Pacientët që marrin barna parenterale me një regjim të caktuar të dozimit, siç është heparina me peshë molekulare të ulët: ndërpriteni barin parenteral dhe filloni me Rufixalo 0-2 orë para kohës së planifikuar të administrimit tjetër të barit parenteral.

- Pacientët që marrin vazhdimisht barna parenterale, siç është heparina intravenoze e pafractionuar: fillojnë të marrin Rufixalo në momentin e ndërprerjes.

Kalimi i pacientëve nga Rufixalo në antikoagulantë parenteralë

Doza e parë e antikoagulantit parenteral duhet të jepet në të njëjtën kohë me dozën tjetër të Rufixalos.

Popullatat në rrezik potencialisht më të madh nga gjakderdhja

Rufixalo, ashtu sikur antikoagulantët e tjerë, mund ta rrisë rrezikun nga gjakderdhja.

Kjo është arsyeja pse Rufixalo kundërrindikohet tek pacientët:

- ◆ me gjakderdhje aktive klinikisht domethënëse;
- ◆ me ndonjë lezion ose gjendje, nëse konsiderohet se mbart rrezik të konsiderueshëm nga gjakderdhja e madhe. Kjo mund të përfshijë ndonjë ulcerë gastrointestinale ekzistuese ose të kohëve të fundit, praninë e neoplazmave malinje me rrezik të lartë nga gjakderdhja, dëmtimet e kohëve të fundit të trurit ose të palcës kurrizore, ndërhyrjet kirurgjikale të kohëve të fundit në tru, shpinë ose sy, gjakderdhjen intrakraniale të kohëve të fundit, varicet e konfirmuara ose të dyshuara të ezofagut, keqformimet arteriovenoze, aneurizmat vaskulare ose anomalitë e mëdha vaskulare intraspinale ose intracerebrale;
- ◆ që mjekohen njëkohësisht me ndonjë antikoagulant tjetër, p.sh. heparinë të pafractionuar, heparinë me peshë molekulare të ulët (enoksaparinë, dalteparinë e të tjera), derivate të heparinës (fondaparinuks e të tjera), antikoagulantë oralë (varfarinë, dabigatran eteksilat, apiksaban e të tjera), përveç në situata të ndryshimit të terapisë antikoagulante ose kur heparina e pafractionuar jepet në doza të nevojshme për ta mbajtur të hapur ndonjë kateter venoz qendror ose arterial;
- ◆ me sëmundje të mëlçisë të shoqëruar me koagulopati dhe ndonjë rrezik klinikisht domethënës nga gjakderdhja, duke përfshirë pacientët me cirrozë të mëlçisë, fazat B dhe C sipas klasifikimit Child-Pugh.

Popullsia e moshuar: Rreziku nga gjakderdhja rritet me moshën.

Disa nëngrupe pacientësh janë në rrezik më të madh nga gjakderdhja dhe duhet të monitorohen nga afër për shenja dhe simptoma të ndërlikimeve të gjakderdhjes.

Vendimi për mjekimin e këtyre pacientëve duhet të merret pas vlerësimit të dobive të mjekimit në raport me rrezikun nga gjakderdhja.

Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave

Për pacientët e rritur, shih "Udhëzimet e dozimit" për pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave mesatar (pastrimi i kreatininës 30-49 ml/min) ose të rëndë (pastrimi i kreatininës 15-29 ml/min).

Rufixalo duhet të përdoret me kujdes tek pacientët me pastrim të kreatininës prej 15-29 ml/min dhe tek pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave¹ që marrin njëkohësisht barna të tjera që i rrisin përqendrimet plazmatike të rivaroksabanit.

Rufixalo nuk rekomandohet për përdorim tek pacientët me pastrim të kreatininës <15 ml/min.

¹ me funksion të veshkave mesatarisht të dëmtuar (pastrimi i kreatininës 30-49 ml/min) për Rufixalo 2.5 mg dhe 10 mg

Pacientët që marrin njëkohësisht edhe barna të tjera

- ♦ Antifungalët sistemikë azole (si ketokonazoli, itrakonazoli, vorikonazoli dhe pozakonazoli) ose frenuesit e proteazës HIV (p.sh. ritonaviri): përdorimi i Ruffixalos nuk rekomandohet.
- ♦ Është e nevojshme t'u kushtohet vëmendje pacientëve që marrin njëkohësisht barna që kanë efekt në hemostazë, siç janë barnat anti-inflamatore jo-steroidë (NSAIDs), acidi acetilsalicilik, frenuesit e grumbullimit të trombociteve ose frenuesit selektivë të rimarrjes së serotoninës (SSRIs) dhe frenuesit e rimarrjes së magazinimit të serotoninës dhe noradrenalinës (SNRIs).
- ♦ Pacientët pas ACS dhe pacientët me CAD/PAD: pacientët e trajtuar me Ruffixalo dhe barna antitrombocitare mund të mjekohen në të njëjtën kohë me barna anti-inflamatore jo-steroidë vetëm nëse dobia është më e madhe se rreziku nga gjakderdhja.
- ♦ Ndërveprimi me eritromicinë, klaritromicinë ose flukonazol ndoshta nuk është klinikisht domethënës tek shumica e pacientëve, por mund të jetë potencialisht domethënës tek pacientët me rrezik të lartë (në rast të funksionit të dëmtuar të veshkave - shih tekstin më lart)

Pacientët me faktorë të tjerë të rrezikut nga gjakderdhja

Ashtu si barnat antitrombocitare të tjera, Ruffixalo nuk rekomandohet për pacientët me rrezik të shtuar nga gjakderdhje, të cilët kanë:

- ♦ çrregullime të gjakderdhjes kongjenitale ose të fituar;
- ♦ hipertension të rëndë arterial të pakontrolluar;
- ♦ ndonjë sëmundje tjetër gastrointestinale pa ulcerë aktive që mund të çojë në ndërlikime me gjakderdhje (p.sh. sëmundje inflamatorë të zorrëve, ezofagit, gastrit, etj.) apo sëmundje të refluksit gastroezofageal);
- ♦ retinopati vaskulare;
- ♦ bronhektazi ose histori të gjakderdhjes pulmonare.

Pacientët me kancer

Pacientët me sëmundje malinje mund të kenë njëkohësisht rrezik të shtuar nga gjakderdhja dhe tromboza. Vlerësimi nëse dobia e terapisë antitrombocitare është më e madhe se rreziku nga gjakderdhja duhet të bëhet ndaras për secilin pacient me sëmundje malinje aktive dhe varësisht nga vendndodhja e tumorit, terapisë antineoplastike dhe fazës së sëmundjes. Tumoret që gjenden në traktin gastrointestinal ose gjenitourinar janë ndërlidhur me një rrezik të shtuar nga gjakderdhja gjatë mjekimit me Ruffixalo. Tek pacientët me neoplazma malinje me rrezik të lartë nga gjakderdhja, përdorimi i Ruffixalos kundërrindikohet (për më shumë informata, shih tekstin më lart).

Kundërrindikacionet e tjera

Ruffixalo kundërrindikohet gjatë shtatzënisë dhe laktacionit. Gratë në moshë riprodhuese duhet ta shmangin shtatzëninë gjatë marrjes së Ruffixalos. Ruffixalo kundërrindikohet edhe në rast të hipersensitivitetit ndaj substancës aktive ose ndonjëres ekscipiente.

Mbidoza

Për shkak të përthithjes së kufizuar, efekti maksimal pa e rritur më tej ekspozimin mesatar të plazmës pritet në doza që janë më të larta se ato terapeutike, domethënë 50 mg Ruffixalo ose më shumë tek të rriturit. Në rast të mbidozimit, mund të merret në konsideratë marrja e qymydrurit të aktivizuar për ta zvogëluar përthithjen.

Nëse tek pacientët që marrin Ruffixalo shfaqen komplikime me gjakderdhje, doza tjetër e Ruffixalos duhet të shtyhet ose mjekimi duhet të ndërpritet në një mënyrë të përshtatshme. Qasja individuale ndaj mjekimit të gjakderdhjes përfshin:

- mjekimin simptomatik, siç është kompresimi mekanik, ndërhyrja kirurgjikale, zëvendësimi i lëngjeve;
- mbështetjen hemodinamike; transfuzionin e produkteve ose përbërësve të gjakut;
- Nëse gjakderdhja nuk mund të kontrollohet me masat e mësipërme, duhet të merret në konsideratë përdorimi i një frenuesi specifik të faktorit Xa (andexanet alfa) ose një agjenti specifik të koagulimit, siç është koncentrat i kompleksit të protrombinës (aPCC), kompleksi i protrombinës i koncentruar i aktivizuar (aPCC) ose faktori rekombinant VIIa (r-FVIIa). Megjithatë, aktualisht ekziston një përvojë klinike shumë e kufizuar e përdorimit të këtyre barnave tek pacientët e rritur.

Për shkak të shkallës së lartë të lidhjes me proteinat e plazmës, nuk pritet që Ruffixalo të mund të hiqet nga trupi me anë të dializës.

Testet e koagulimit

Ruffixalo nuk kërkon monitorim rutinor të parametrave të koagulimit. Megjithatë, matja e niveleve të Ruffixalos në gjak mund të jetë e dobishme në situata të caktuara kur informatat për ekspozimin ndaj Ruffixalos mund të ndihmojnë në vendimmarrjen klinike, siç është mbidoza dhe kirurgjia emergjente.

Testet anti-faktor Xa, me kalibratorë specifikë të rivaroksabanit, janë aktualisht në dispozicion komercialisht për t'i matur nivelet e rivaroksabanit. Nëse indikohet klinikisht, statusi hemostatik mund të përcaktohet nga koha e protrombinës (RT) duke e përdorur Neoplastinën, siç përshkruhet në "Përmbledhjen e karakteristikave të produktit".

Vlerat e parametrave të mëposhtëm të koagulimit janë të larta: koha e protrombinës (PV), koha e tromboplastinës së pjesshme e aktivizuar (aPTT) dhe Raporti ndërkombëtar i normalizuar i llogaritur (INR). Testimi INR është zhvilluar për t'i përcaktuar efektet e VKA-së dhe, për këtë arsye, nuk është i përshtatshëm për matjen e aktivitetit të Ruffixalos. Vendimet për dozimin dhe mjekimin nuk duhet të bazohen në rezultatet e INR-së, përveç kur kaloni nga Ruffixalo në VKA siç është përshkruar më parë.

Pasqyrë e përgjithshme e dozimit tek pacientët e rritur*

Indikimi	Doza	Popullatat e veçanta
Parandalimi i goditjes në tru dhe embolizmit sistematik tek pacientët e rritur me fibrilacion atrial jovalvular	Rufixalo 20 mg një herë në ditë	Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave (pastrimi i kreatininës 15 – 49 ml/min) Rufixalo 15 mg një herë në ditë. PCI për vendosjen e stendës Periudha maksimale deri në 12 muaj – Rufixalo 15 mg një herë në ditë plus një frenues P2Y12 (p.sh. klopidoqrel). PCI me vendosje të stendës Tek pacientët me dëmtim të veshkave (pastrimi i kreatininës 30-49 ml/min) Rufixalo 10 mg një herë në ditë plus një frenues P2Y12 (p.sh. klopidoqrel).
Mjekimi i DVT dhe PE-së dhe parandalimi i përsëritur i DVT-së dhe BE-së tek pacientët e rritur	Mjekimi dhe parandalimi i përsëritjeve, nga dita e parë deri në ditën e njëzetënjtë: Rufixalo 15 mg dy herë në ditë Parandalimi i përsëritjes, nga dita e njëzetëdytë e tutje: Rufixalo 20 mg një herë në ditë Parandalimi i zgjatur i përsëritjeve, nga muaji i shtatë e tutje Rufixalo 10 mg një herë në ditë Parandalimi i zgjatur i përsëritjeve, nga muaji i shtatë e tutje Rufixalo 20 mg një herë në ditë tek pacientët që konsiderohen me rrezik të lartë nga DVT ose BE të përsëritur, siç janë pacientët: ☐ me komorbiditete të komplikuara;	Pacientët me funksion të dëmtuar të veshkave (pastrimi i kreatininës 15 – 49 ml/min) Mjekimi dhe parandalimi i përsëritjeve, nga dita e parë deri në ditën e njëzetënjtë: Rufixalo 15 mg dy herë në ditë. Pastaj Rufixalo 15 mg një herë në ditë në vend të Rufixalo 20 mg një herë në ditë, nëse pacienti vlerëson se rreziku i gjakderdhjes e tejkalon rrezikun e DVT-së ose BE-së përsëritëse. Me dozën e rekomanduar të Rufixalo 10 mg një herë në ditë, nuk ka nevojë për përshtatje të dozës. Dozat

	☐ që kanë zhvilluar DVT ose PE të përsëritur, me profilaksi të zgjatur me Rufixalo 10 mg një herë në ditë.	
Parandalimi i VTE-së tek pacientët e rritur që i nënshtrohen një procedure kirurgjikale zgjedhore të implantimit të legenit apo gjunjëve artificiale	Rufixalo 10 mg një herë në ditë	
Parandalimi i ngjarjeve aterotrombotike tek pacientët e rritur me CAD ose PAD simptomatike dhe me rrezik të lartë nga ngjarjet ishemike	Rufixalo 2.5 mg dy herë në ditë në kombinim me acid acetilsalicilik 75 deri në 100 mg/ditë	
Parandalimi i ngjarjeve aterotrombotike tek pacientët e rritur pas ACS-së me biomarkerë kardiakë të rritur	Rufixalo 2.5 mg dy herë në ditë në kombinim me terapi antitrombotike standarde (vetëm acid acetilsalicilik 75–100 mg/ditë ose acid acetilsalicilik 75–100 mg/ditë me 75 mg/ditë klopidoqrel ose tiklopidinë me dozë standarde)	

Tabletat Rufixalo 15 dhe 20 mg duhet të merren me ushqim.

Për pacientët që nuk mund ta gëlltisnin tërë tabletën, tableta Rufixalo mund të shtypet dhe të përzihet me ujë ose pure molle menjëherë para se të merret dhe të aplikohet oralisht.

^a me një ose më shumë faktorë rreziku, siç janë pamjaftueshmëria kardiake kongjестive, hipertensioni, mosha mbi 75 vjeç, diabeti mellitus, goditja në tru ose ataku ishemik kalimtar.

^b Përdoreni me kujdes tek pacientët me pastrim të kreatininës 15-29 ml/min dhe tek pacientët me dëmtim të veshkave të cilët marrin njëkohësisht barna të tjera që i rrisin përqendrimet plazmatike të rivaroksabanit.

^c Nuk rekomandohet si alternativë ndaj heparinës së pafraksionuar tek pacientët me PE që janë hemodinamikisht të paqëndrueshëm ose që kërkojnë trombolizë ose embolektomi pulmonare.

Raportimi i efekteve anësore

Pas marrjes së vendimit për ta vënë këtë bar në treg, është e rëndësishme ta raportoni çdo dyshim për reaksione negative të shkaktuara nga ky bar. Kjo e lejon monitorimin e shkallës së dobisë dhe rrezikut të barit.

Të gjitha efektet anësore të dyshuara duhet të raportohen në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Paisje dhe Medicinale (AKPPM). AKPPM inkurajon punonjësit e kujdesit shëndetësor të raportojnë efektet anësore të dyshuara duke plotësuar formularin e raportimit për efekte anësore që mund ta shkarkoni në webfaqen e AKPPM-së (<https://akppm.rks-gov.net/>) dhe ta dërgoni në njërën nga mënyrat e mëposhtme:

Në mënyrë elektronike: info.akppm@rks-gov.net

Me postë: Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale- Lagjia e Spitalit (Q.K.U.K), 10000 Prishtinë, Kosovë.

Të dhënat kontaktuese të personit të autorizuar juridik të Bartësit të Autorizimit për Marketing të produktit medicinal:

Mr.Ph.Venera Komoni

Personi përgjegjës lokal për farmakovigilencë

Mobil: +383 45 266 023

Zyra: +381 38 606 011

Faks: +381 38 606 008

E-mail: vkonomi@Alkaloid.com.mk



Vodič za lekare sa informacijama o primeni leka Ruffixalo® (rivaroksaban)

Ovaj vodič predstavlja edukativni materijal koji je obavezan uslov za stavljanje leka Ruffixalo® u promet, sa ciljem dodatne minimizacije odabranih važnih rizika.

Bez promotivnog sadržaja.

Informacije navedene u ovom edukativnom materijalu ne zamenjuju informacije navedene u Sažetku karakteristika leka (SmPC). Za potpune informacije pre primene ovog leka, molimo vas da pročitate Sažetak karakteristika leka.

